



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.02.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Fatmir Velaj, Reme Lala dhe Ligoraq Karamelo.

Mungojnë:

Rudina Hajdari dhe Halit Valteri.

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

Sonila Hysi - Drejtoreshë Ekzekutive e AKD-së

Klaudia Hasanllari - Drejtoreshë e Drejtorisë së Diasporës

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 24 shkurt 2021.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Ky propozim vjen nga deputeti Shameti, prandaj për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera jemi komision përgjegjës. Relator kemi kolegun Hyseni.

Të ftuar kemi zotin Pandeli Majko, ministër i Shtetit për Diasporën. Mirë se erdhët, zoti Pandi, si gjithmonë shumë korrekt!

Në linjë duhet të kemi zonjën Hasanllari, drejtoreshë e Drejtorisë së Diasporës dhe zonjën Hysi, drejtoreshë Ekzekutive e AKD-së.

Pa humbur kohë, fillojmë me shqyrtimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Propozimi vjen nga zoti Shameti.

Zoti Shameti, a do të flisni dy fjalë në lidhje me propozimin tuaj dhe më pas kalojmë te relatori dhe te ministri?

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu sikurse ju e referuat në fjalën hyrëse, bëhet fjalë për një propozim për ndryshim në ligjin që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

Shkurtimisht dua të sqaroj kolegët se kemi të bëjmë me një ndërhyrje apo sqarim që ishte i nevojshëm në këtë ligj, për arsye se kemi të bëjmë me procedura prokurimi, të cilat kanë të bëjnë me aktivizimin e këngëtarëve apo të rrjeteve të ndryshme, të cilat mund të aktivizohen në veprimtaritë që kjo ministri zhvillon jashtë shtetit. Duke qenë se nga kontrollet periodike të organizuara, si nga Ministria e Financave dhe më tej janë konstatuar të rregullta si procedura, por është orientuar drejt ndërhyrjes në ligj dhe më pas rregullimit me një VKM të prokurimeve të vogla që kanë të bëjnë me këto veprimtari, atëherë gjetëm të domosdoshme dhe të nevojshme që ta paraqisnin këtë nismë ligjore. Kurse 2-3 pikat e tjera janë thjesht axhustime për të bërë harmonizimin e ligjit me ligjet e tjera. Unë nuk dua të marr më shumë kohë te prezantimi i ligjit, por jam i sigurt që te relatimi zoti Hyseni do të sqarojë edhe detajet teknike. Ajo që është e rëndësishme, është se ndryshimet që kemi propozuar në këtë ligj nuk kanë efekte financiare dhe kemi pasur dhe dakordësinë e Ministrisë së Financave nga ana tjetër për t'i bërë këtë rregullime, siç jua kemi paraqitur.

Faleminderit dhe mbetem i hapur nëse ka pyetje apo diskutime për të bërë sqarime!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Shameti!

Zoti Hyseni, fjala për ju si relator.

Alket Hyseni – Përshëndetje, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Sot kemi për shqyrtim në Komisionin e Politikës së Jashtme, si komision përgjegjës, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Kjo strukturë është ideuar nga qeverisja e Partisë Socialiste, pikërisht me synimin për t’i bërë të mundur atij numri shumë të madh shqiptarësh, që janë në diasporë, dhe kur themi diasporë, kudo ku jetojnë në botë, për të pasur kontakt me dheun e nënës, me Shqipërinë dhe për t’u mundësuar edhe një pjesë të shërbimeve dhe për të mundësuar ruajtjen e gjuhës, të kulturës, të traditave, pra të mos u ndier si larg vendit, por për ta afruar vendin me ata dhe për t’i afruar ata me vendin. Në këtë fokus në vitin 2017 është miratuar ligji dhe është krijuar kjo agjenci për herë të parë dhe ka filluar funksionimin. Gjatë funksionimit të saj është parë e udhës për të bërë disa ndryshime në ligj, të cilat do ta përmirësonin dhe do të lehtësonin punën e kësaj agjencie.

Projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe në përputhje me Rregulloren e Kuvendit për t’u marrë në shqyrtim nga komisioni dhe për t’i vazhduar procedurat më tej.

Ku konsistojnë ndryshimet në këtë projektligj?! Projektligji është ndarë në 5 nene, pra janë 5 ndryshime kryesore.

Së pari, ka të bëjë me disa ndryshime në kompetencat e këshillit drejtues për sa i përket miratimit të rregullores, organizimit dhe funksionimit të brendshëm administrativ të kësaj agjencie.

Ky ndryshim, në fakt, mbështetet edhe në rekomandimin e njësisë të auditit në lidhje edhe me hartimin e rregullores përkatëse për funksionimin dhe procedurat e vendimmarrjes së vetë këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Pra, duke ndryshuar nenin 8, germa “b” dhe “ç” të këtij ligji; germa “ç” ka lidhje me shqyrtimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave të punonjësve të kësaj agjencie për të proceduar më tej me propozimin drejt ministrit të linjës, i cili, në përputhje me nenin 5, pika 4, të këtij ligji, ia kalon për miratim Këshillit të Ministrave, Kryeministrit.

Në nenin 2 propozohet që të shtohet neni 10/1 pas nenit 10 në lidhje me disa kompetenca të veçanta të agjencisë për sa u përket prokurimeve të veçanta që kryen kjo agjencia. Ka pasur disa problematika në punën e përditshme të agjencisë, e cila, në funksion

të misionit të saj, për zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, në zbatim të programit të aktiviteteve që ka parashikuar, aktivitete të ndryshme, organizime kulturore, artistike, aktivitete me natyrë akademike, marrje me qira ambientesh apo salla për kryerjen e aktiviteteve jashtë vendit, lidhje kontratash të ndryshme shërbimi për shfaqje me artistë, me këngëtarë të ndryshëm, me etnografë, me etnomuzikologë, pra çdo lloj artistësh, që kanë të bëjnë me misionin bazë të përcimit të kulturës dhe traditave shqiptare.

Për sa i përket këtij funksioni dhe realizimit të këtij bashkëpunimi, për zbatimin e programit të këtyre aktiviteteve në raportin përfundimtar të auditit të Ministrisë së Financave është përcaktuar që agjencia duhet të përcaktojë me akt ligjor procedurat për kryerjen e këtyre aktiviteteve, pasi edhe nga legjislacioni për prokurimin publik këto aktivitete nuk janë në fushën apo në objektin e veprimtarisë së këtij ligji, në objektin e rregullimit të ligjit të prokurimit publik. Në këtë këndvështrim, ka pasur një vakuum, i cili duhet të plotësohet për t'i dhënë mundësi dhe operativitet agjencisë për t'i kryer këto veprime në përputhje me ligjin.

Në nenin 3 propozohet që në pikën 1 të nenit 13 pas togfjalëshit “të autoriteteve shtetërore” të shtohet dhe “njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Ky ndryshim merr spunto nga ndryshimet që bëjnë në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, duke përcaktuar një rol të organeve të vetëqeverisjes vendore për sa u përket kontakteve dhe aktiviteteve me diasporën.

Në fund, në nenin 4: pika 1 e nenit 16 kërkohet të ndryshohet roli i Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, pra vendimeve të tij, në zbatim të neneve të 7, pika 5; nenit 10, pika 1; nenit 11, nenit 13, pika 2 dhe nenit 14, pika 2, të këtij ligji.

Ju bëj me dije se projektligji nuk ka asnjë efekt financiar, pra nuk involvon efekte financiare dhe e gjithë veprimtaria e agjencisë mbulohet normalisht nga buxheti i përcaktuar për këtë agjenci.

Në këto kushte, unë, si relator, dua t'ju ftoj që ta miratojmë në parim, por edhe nën këto iniciativë të prezantuar nga deputeti Adnor Shameti, por i konsultuar edhe me agjencinë, natyrisht, me ministrin e linjës, që besoj se edhe do të ketë të drejtën e fjalës për të bërë një prezantim të nevojës që kanë pasur agjencia dhe ministria për këto ndryshime ligjore, pra ashtu sikurse thashë, për t'i bërë të mundur kësaj ministrie dhe kësaj agjencie lehtësimin dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara, të cilat nuk janë edhe aq të lehta, janë misione, të cilat kryhen jashtë vendit dhe, nëse do t'i krijojmë artifice, do t'i pamundësojmë ose do të vonojmë kryerjen e këtyre shërbimeve, të cilat janë të domosdoshme për t'u kryer nga ministri.

Ju ftoj ta miratojmë këtë ligj, i cili vjen në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren nga pikëpamja e procedurës dhe nga pikëpamja e themelit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Hyseni, për skrupolozitetin me të cilin relatuat!

Besoj se ditën e martë, javën tjetër, besoj se do ta kalojmë nen për nen shqyrtimin e projektligjit. Rregullorja na e kërkon këtë, ndaj edhe sot kemi shqyrtimin në parim të tij. Nëse ministri Majko ka ndonjë gjë për të shtuar, është i lutur ta bëjë.

Zoti Majko.

Pandeli Majko – Jam plotësisht dakord me të dy parafolësit. Prezantimet e tyre ishin shteruese, kështu që nuk kam ndonjë gjë për të shtuar.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

A ka pyetje dhe diskutime?

Zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e mbështes ligjin plotësisht, duke pasur dashurinë e madhe të zotit Shameti për diasporën dhe përkushtimin e palëkundur të ministrit Majko ndaj shqiptarëve jashtë vendit.

Ju lutem, zonja kryetare, na i kurseni ndërhyrjen tuaj. Ky është Komisioni për Politikën e Jashtme, jo komisioni i politikës së realizimit socialist. Ky është një ligj që rregullon disa aspekte teknike për sa i përket prokurimit publik, ka një boshllëk ligjor. Po marr guximin të presupozoj edhe për anëtarët e tjerë, besoj se të gjithë jemi dakord që t'i mbështesim këto ndryshime, që rregullojnë hapësirat boshe të kuadrit ligjor, por nuk ka nevojë për gjuhë demagogjike të tipit: “Shqiptarët jashtë vendit kanë nevojë për këto rregullime, për të pasur kontakt me dheun mëmë e të tjerë”, sepse, edhe shqiptari më i keqpaguar jashtë Shqipërisë merr 3-fishin e rrogës së një deputeti. Kështu që nuk ka nevojë për rregullime të kuadrit ligjor një shqiptar jashtë shtetit për të pasur kontakt me mëmëdhenë, atdheun ose Shqipërinë.

Një gjë donin shqiptarët e diasporës, dhe dua që ta përmend këtë, zonja kryetare, e cila nuk ka lidhje fare me projektligjin, ishte vota në vendet ku ata janë rezident, u propagandua jashtë mase nga Partia Socialiste dhe nga maxhoranca gjatë dy vjetëve që unë kam qenë në parlament, por nuk u krijua mundësia, duket qartë që intencioni politik është për të transferuar përgjegjësinë dhe për të krijuar një alibi, duke ia transferuar të gjithë fajin KQZ-së, kjo duket se do të ndodhë shumë shpejt, për t'ia vënë fajin KQZ-së dhe për të hequr të gjithë përgjegjësinë nga supet e Partisë Socialiste, e cila nuk është më e interesuar që t'i japë të drejtën e votës diasporës. Ne, si deputetë, duhet ta pranojmë që kemi dështuar në krijimin e kësaj hapësire dhe realizimin e kësaj aspirate të diasporës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, nënkryetar!

Ky ka qenë një diskutim i kahershëm, zoti Gjoni, lidhur me çfarë diskutohet në Komisionin e Politikës së Jashtme, si diskutohet, bazuar në Rregulloren, që rregullon punën e komisioneve, por edhe në Rregulloren, që rregullon punën e Kuvendit të Shqipërisë.

Unë besoj se në çdo komision ka një mënyrë të caktuar drejtimi dhe një mënyrë të caktuar të marrëveshjes sesi në komunikojmë me njëri-tjetrin. Këto janë të pashkruara, por janë ligje më të forta se sa ato të shkruara, kjo nuk është vetëm në rastin e punës së komisionit tonë, por në përgjithësi vetë shoqëria ka ligje të pashkruara apo kode të etikës, që i tejkalojnë ligjet e shkruara dhe rezistojnë më gjatë. Ndaj në komision shpeshherë kemi thënë që, në qoftë se ka një diskutim, që është përtej dhe jashtë fokusit për të cilin jemi mbledhur dhe rendit të ditës për të cilin jemi mbledhur, për fat të mirë, Kuvendi i Shqipërisë dhe ne të gjithë, si anëtarë pjesë e saj, kemi një tribunë, ku mund të themi shumëçka, përtej kohës së limituar, që i lejojmë vetes në mbledhjet e këtij komisioni. Kështu që, mund të themi edhe gjëra që kanë të bëjnë me politikën e madhe, siç janë edhe këto që po diskutohen. Duke thënë këtë, në mënyrën sesi komunikojmë bashkë në komision, kemi rënë dakord për disa rregulla, të tipit që askush nuk diskuton mbi diskutimin e tjetrit, sigurisht shpreh opinionin e vet, nuk ke pse të komentosh e të vësh epitete ndaj të tjerëve dhe të tjerët ndaj teje, apo gjithsekush ndaj njëri-tjetrit lidhur me mënyrën sesi flet, sesi relaton dhe sesi i paraqet opinionet e veta, ti ke një opinion tëndin, të cilin e thua qetësisht, e merr kohën që ke nevojë të marrësh dhe nuk do të lejoj që të kemi komente për njëri-tjetrin për mënyrën sesi kemi relatuar, sesi flasim dhe, aq më pak, nuk do të lejoj që të vihen epitete.

Revokimet e kohës së kaluar janë bërë kaq shumë banale, sa që nuk afektojnë më askënd. Unë nuk jam në mbrojtje të Alketit, si koleg i mirë i komisionit, por në mbrojtje, duke filluar nga ju, të gjithsecilit, që etiketon, pa qenë e nevojshme fare të etiketohet në gjërat që thotë, sepse mund t'i shprehë ato bazuar në opinionin e vet pa u mbështetur te fjala apo opinionin e kolegut.

Unë do të doja që zoti Hyseni të mos jepte një përgjigje, por që ka të gjithë të drejtën ta japë. Po të më pyes mua, zoti Hyseni, do t'i thosha që nuk është e nevojshme të kthesh një përgjigje, sepse ka disa përgjigje, që nuk meritohen të jepen. Të gjithë e dimë që diaspora ka nevojë për mbështetje, të gjithë e dimë që deri dje nuk ka pasur një ministri të diasporës, por që sot ka. Rruga ka qenë e vështirë dhe do të vazhdojë të jetë e vështirë dhe e gjatë, por, absolutisht, e pamundur. Për ato që kemi arritur në deri sot, me krijimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, me ministrin Majko në krye të punëve, me të gjitha agjencitë,

rregulloret dhe të gjithë bazën ligjore, që kemi ndërtuar bashkërisht, edhe me ndihmën tënde, edhe me ndihmën e të gjithëve që janë nga opozita në komision, besoj se kemi bërë shumëçka, ka ende shumë për të bërë, por nuk na ndalon që të vazhdojmë t'i bëjmë me besimin e plotë që jemi duke bërë më të mirën, ndoshta jo të pamundurën, për shqiptarët jashtë shtetit. Kështu që, është e panevojshme të etiketojmë diskutimet e njëri-tjetrit kur jemi duke precizuar disa gjëra, të cilat do të ndihmojnë në punën dhe mirëfunksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, punën e ministrisë, por edhe punën tonë në suport të njerëzve që jetojnë jashtë.

Alket Hyseni - Nuk i heq asnjë presje dhe nuk do të komentoj lidhur me deklaratat e kolegëve. Unë synova të shpreh qëllimin që kemi pasur me krijimin e kësaj Agjencie dhe kësaj Ministrie. Ne kemi një diasporë, e cila patjetër që është larguar për një jetë ekonomike më të mirë dhe, patjetër, që mesatarisht dhe individualisht janë të mirëpaguar krahasuar me shqiptarët në Shqipëri, por kjo nuk u mundëson atyre kontaktin me kulturën pa ndihmën e shtetit të tyre, pa ndihmën e qeverisë së Shqipërisë, për këtë arsye u ideua kjo agjenci dhe kjo ministri. Pavarësisht pagesave të larta, pagave 3-fish apo 5-fish, ndoshta më shumë se deputetët këtu, për ata që merren me biznes në diasporë, e rëndësishme është që ne t'u mundësojmë evente kulturore, të cilat ata, pavarësisht të ardhurave, nuk i mundësojnë dot vetë. Eventet akademike për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave ata vetë atje nuk i mundësojnë.

Nga ana tjetër, meqenëse u ngrit çështja e votës, ne duhet të jemi krenarë si komision, por edhe si parlament, që për herë të parë, pavarësisht dëshirës së madhe të Partisë Socialiste, meqenëse e përmendet, sepse unë nuk bëra politikë me këtë çështje, ne e kishim kushtin absolut të panegociueshëm në Komisionin e Reformës kemi pasur çështjen e votës së diasporës, nëse të tjerët vendosën kushte për sistemin, ata që flasin, ne vendosëm dy kushte: njëri ishte plotësimi i rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it dhe i dyti ishte vota shqiptarëve jashtë vendit. Ne hoqëm dorë nga rekomandimet për shkak të opozitës, por nuk hoqëm dorë nga kërkesa jonë për votën. A e realizuam 100%?! Unë mendoj se për herë të parë Kodi Zgjedhor shqiptar ka hapësirën e plotë ligjore për mundësinë e votës së emigrantëve atje ku ndodhen. Kjo hapësirë ligjore kërkon plotësimin e teknikaliteteve nga ana e KQZ-së, i cili është duke punuar për t' dhënë akses dhe për të përcaktuar metodologjinë sesi shqiptarët jashtë atdheut do ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës.

Unë uroj dhe shpresoj shumë që një pjesë e emigrantëve ta kenë të mundur që në këto zgjedhje, por edhe, nëse nuk do të mundën për këto zgjedhje, jam i bindur që në zgjedhjet që do të vijnë emigrantët do të kenë të gjithë mundësinë për të votuar, ju kërkoj

ndjesë, sepse ata nuk quhen më emigrantë, por shqiptarët jashtë atdheut, do të kenë mundësinë që të vetregjistrohen, të përcaktojnë adresën dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës atje ku ata jetojnë dhe punojnë vetë, me familjet e tyre, apo me komunitetet shqiptare në vendet përkatëse. Ajo që duhet të bëjmë ne është për çdo iniciativë që ka Ministria e Diasporës apo ministritë e tjera, ne, si Komision i Jashtëm, t'u jemi në krah dhe t'i mbështesim. Ky ishte synimi i kësaj nisme.

Këtu falënderoj edhe kolegun, që e mbështeti këtë nismë! Kjo është e rëndësishme, pjesa tjetër nuk ka rëndësi fare, sepse ne ndoshta nuk mund të përputhemi me njëri-tjetrin në çdo deklaratë e çdo fjalë, por e rëndësishme është që në gjëra themelore, siç është qëllimi i mirë i kësaj iniciative, të biem dakord.

Faleminderit dhe ndjesë që u zgjata!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Hyseni!

Mendoj që ta hedhim në votim.

Kush është dakord me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”? Janë dakord të gjithë. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shihemi të martën për diskutimin nen për nen dhe për diskutimin e një marrëveshjeje tjetër.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA